

## ZGJIDHJA URBANISTIKE

### PËRMBAJTJA

#### A. Pjesa tekstuale

1. KONCEPTI THEMELOR I ORGANIZIMIT DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË PLANIT RREGULLATIV	3
2. NDARJA NË ZONA TË CILAT I KARAKTERIZOJNË FUNKSIONET NË VEÇANTI	5
3. KARAKTERISTIKAT E TËRËSIVE URBANE	6
TËRËSIA "A"	6
TËRËSIA "B"	9
TËRËSIA "C"	12
TËRËSIA "D"	15
TËRËSIA "E"	18
TËRËSIA "F"	21
4. RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PARCELAVE SIPAS TËRËSIVE URBANE	24
5. RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË TOKËS (PARCELIMET, NIVELIMET DHE RREGULLIME	33
6. RREGULLAT E NDËRTIMIT (TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË NDËRTIMIT)	35
TËRËSIA A – Kryesisht me destinim të përzier (banim kolektiv dhe biznes	35
TËRËSIA B – Kryesisht me destinim të përzier (banim kolektiv dhe biznes)	38
TËRËSIA C – Kryesisht me destinim banimi kolektiv me hapësirat përcjellëse për banorë	44

TËRËSIA D – kryesisht me destinim banimi kolektiv me hapësirat përcjellëse për banorë	47
TËRËSIA E – Ekonomi e vogël	49
TËRËSIA F – Gjelbërimi i qytetit	57
7. Rregullimi i rrjetit të sipërfaqeve të komunikacionit	63
8. Rrjeti elektroenergjetik	69
9. Rrjeti i telekomunikimit	72
10. Ngrohja	74
11. Ujësjiellësi, kanalizimi fekal dhe atmosferik	77
12. Rregullimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rekreative	82
13. Mënyra e implementimit të planit rregullativ	87

## B. Pjesa grafike

01. Zhvillimi urban i Prishtinës sipas Planit Strategjik	
02. Zhvillimi urban i Kalabrisë sipas Planit Strategjik	
03. Rrugët primare dhe elementet analitike	1:3000
04. Profilet tërthore të rrugëve	1:100
04b. Prerjet e terrenit	1:2500
05. Destinimi i sipërfaqeve	1:3000
06. Parcelimi	1:3000
07. Ujësjiellësi	1:3000
08. Kanalizimi fekal dhe atmosferik	1:3000
09. Elektri dhe telefonia	1:3000
10. Ngrohja	1:3000

## **1. KONCEPTI THEMELOR I ORGANIZIMIT DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË PLANIT RREGULLATIV**

### **1.1. Koncepti themelor i planit**

Koncepti themelor i planit bazohet në drejtimet e Planit Strategjik Zhvillimor të Prishtinës i cili këtë zonë e ka identifikuar si koncept të ri urbanistik me dominim të funksioneve publike, afariste dhe kulturore.

Dominimet e veçanta paraqesin tërësi të funksioneve publike, kulturore, rekreative dhe funksioneve afariste të cilat me masat dhe instrumentet e planit posaçërisht favorizohen si bartëse të zhvillimit të qytetit të Prishtinës.

### **1.2. Ndarja e territorit**

Ndarja e hapsirës së Lagjes së Kalabrisë bazohet në principin e hierarkisë dhe funksionit të organizimit të territorit.

Territori ndahet në:

1.0. Tërësi (A, B, C, D, E, F)

2.0. Blloqe

3.0. Parcelat brenda bllokut

### **1.3. Bilancet e destinimit sipas tërësive dhe blloqeve**

Bilancet e sipërfaqeve me këtë Plan Rregullativ janë dhënë në formë tabelare të ndara sipas llogarive dhe strukturave në bazë të planifikimit të tërësisë urbane në plan.

*Niveli i parë* - Bilanci në nivel të zonës sipas planit rregullativ nënkupton llogaritjet e strukturave të operacioneve numerike, gjegjësisht prezenton bilansin në nivel të zonës në shumën totale.

Në tabela jepen shënimet për blloqet (A, B, C, D, E, F) me shenjat përkatëse të blloqeve.

*Niveli i dytë* – Prezanton operacionet urbanistike në nivelin e bllokut të ndërtimit. Në tabela janë dhënë shënimet për çdo bllok veç e veç, dhe atë shënimet për gjendjen ekzistuese në njërin anë dhe të planifikimit në anën tjetër.

Shënimet për projeksionet janë dhënë sipas nomenklaturave standarde të parametrave urbanistik, sipas kësaj radhe:

- shenja në plan - ShPI
- destinimi
- sipërfaqja e parcelës
- indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)
- indeksi i sipërfaqes së dyshemesë (ISD)
- sipërfaqja bruto nën objekt - SBO
- sipërfaqja e zhvilluar e objekteve - SZhO
- katësia e lejuar – Kat. Lej.
- numri i etazhitetit – Nr. Et
- raporti i banimit dhe afarizmit në përqindje Ban : Af (%)
- sipërfaqja e zhvilluar ndërtimore - Banimi
- sipërfaqja e zhvilluar ndërtimore jobanesore – Afariste
- numri i apartamenteve (standardi i pranuar 80 m<sup>2</sup> bruto) – Nr Apart
- numri i nevojshëm i parkingjeve respektivisht vendeve për garazhim në parcelat (me standarde dhe destinime të ndryshme) – Nr. i VP-G/Lok-Bllok
- Normat dhe standardet ndërkombëtare për çdo lokacion

Vërejtje:

Vazhdojnë tabelat e llogaritjeve për blloqet e banimit.

## **2. NDARJA NË ZONA TË CILAT I KARAKTERIZOJNË FUNKSIONET NË VEÇANTI**

**Lagja “Kalabria”**– E cila është lëndë e planit rregullativ, paraqet zonën urbane të qytetit të Prishtinës sipas planit strategjik zhvillimor. Karakteristikë e kësaj lagje është se kjo zonë sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës bënë pjesë në zonat mikse, e cila në kuadrin e vet do të ketë këto tërësi urbane të cilat janë të shënuara në plan me shkronjat A, B, C, D, E dhe F.

**Tërësia urbane A** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo (sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës) bënë pjesë në zonat mikse urbane ku parashihet banim i dendur dhe biznes me funksione qendrore.

**Tërësia urbane B** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo tërësi sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës bënë pjesë në zonat mikse urbane ku parashihet banim i dendur dhe biznes me funksione qendrore. Karakteristikë tjetër e kësaj tërësie urbane është se territori i saj është i mbuluar me ndërtime të egra të cilat do të zëvendësohen me ndërtime të reja dhe me plan.

**Tërësia urbane C** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo (sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës) bënë pjesë në zonat mikse urbane ku parashihet banim dhe ekonomi në kuadër të kompleksit.

**Tërësia urbane D** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo (sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës) bënë pjesë në zonat kryesisht me banim.

**Tërësia urbane E** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo (sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës) bënë pjesë në zonat për ekonomi të vogël dhe të mesme si dhe hapësira për objekte afariste dhe panairesh.

**Tërësia urbane F** – Karakteristikë e kësaj tërësie urbane është se kjo (sipas planit strategjik të qytetit të Prishtinës) bënë pjesë në zonat për gjelbërim dhe rekreacion për tërë qytetin e Prishtinës. Karakteristikë tjetër e kësaj zone është se territori i saj është i mbuluar me ndërtime të egra të cilat në këtë plan janë të trajtuara dhe si rezultat i këtij trajtimi ato do të konservohen në atë gjendje si janë. Konservim do të thotë që objektet ekzistuese nuk lejohen të riparohen, rekonstruktohen, të mbindërtohen, të zgjerohen me aneks ndërtime dhe të ndërrojnë destinimin për periudhën kohore deri sa është në fuqi Plani Strategjik i Prishtinës.

### **3. KARAKTERISTIKAT E TËRËSIVE URBANE**

#### **TËRËSIA "A"**

##### **Karakteristikat ambientale**

**Tërësia A** e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione afariste, banim i dendur, tregti dhe administratë, si dhe funksione përcjellëse (sheshet, bulevardet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat); parcela për tregun e gjelbërt dhe bulmetit (blloku A1)
- Blloku me funksione afariste, banim i dendur, tregti dhe administratë, si dhe funksione përcjellëse (sheshet, bulevardet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat) (blloku A2)
- Blloku me funksion banimi - në kuadër të të cilit funksionojnë elementet përcjellëse siç janë: hapësira për lojra të fëmijëve, sipërfaqet gjelbëruese dhe rekreative, tregtia, terrenet e pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshet, rrugët interne të bllokut, parkingjet etj. si dhe parcela për shtëpinë e shendetit (blloku A3)
- Blloku me funksion banimi - në kuadër të të cilit funksionojnë elementet përcjellëse siç janë: hapësira për lojra të fëmijëve, sipërfaqet gjelbëruese dhe rekreative, tregtia, terrenet e pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshet, rrugët interne të bllokut, parkingjet etj, parcela për qëndër kulturore (kinema, teatër, objekt rinor), parcela për funksione sociale - kopështi dhe çerdhja e fëmijëve (blloku A4)
- Në të gjitha blloqet duhet të sigurohet parcela për kopështe dhe çerdhe për fëmijë në kuadër të kompleksit të blloqeve
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit

## **Karakteristikat ekologjike**

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijojnë:

- Përcaktimi i masave të shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane
- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individit në vizura, diell dhe ajër
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize.

## **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane A sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës, është i pashmangshëm sepse një pjesë e kasaj tërësie urbane është e mbuluar me ndërtime të egra.

Në këtë territor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja ndërtimi. Të gjitha blloqet në këtë territor janë planifikuar me destinim banimi të dendur kolektiv dhe afarizëm (tregti, biznes, administratë, etj) (A1, A2,) objekte banimi (A3) dhe objekte kulturore (A4) si dhe hapsira me gjelbërim dhe rekreacion.

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të vendbanimeve dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane
- përqindjet e gjelbërimit, të dhëna në standardet urbanistike, për banorët e kësaj tërësie urbane por edhe për banorët e qytetit të Prishtinës

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Varësisht prej destinimit të blloqeve në kuadër të tërësisë urbane objektet e interesit të përgjithshëm mund të dislokohen prej një blloku në një bllok tjetër, nëse implementimi dhe zbatimi i projekteve në blloqe vjen në pyetje, gjegjësisht nuk gjendet gjuha e përbashkët me pronarët e parcelave.

**Etazhiteti** – tërësia A në zonat e ndërtimit kolektiv të objekteve me banim të dendur dhe afarist është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin strategjik të Prishtinës. Meqenëse një pjesë e kësaj zone bënë pjesë në bulevardin e rrugës Mitrovicë – Prishtinë – Shkup dhe Prishtinë – Aeroport është paraparë që etazhiteti të jetë P+3 deri në P+12, ndërsa për pjesët e brendshme ky etazhitet do të jetë prej P+3 deri në P+7. Etazhiteti P+1 do të ketë ISHP-në 0.6 për hapësirat afariste, ndërsa ISHP-ja për pjesën banuese do të jetë 0.3 (ky indeks është rezultat i kërkesave të individëve për të pasur të drejtën e tyre për shfrytëzim të vizurave, ajrit dhe diellit).

**Dendësia e banimit** – për tërësinë “A” është **623 banorë/ha**

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale (kjo nënkuptohet se janë të caktuara sipas sistemit koordinativ).

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv i dendur me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+3 deri P+12), me ISHP 0.6 për objektet afariste dhe ISHP 0.3 për banim.
- Për objektet me karakter të interesit të përgjithshëm (shkollat, shëndetësia, kultura, sporti dhe rekreacioni etj.) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok.

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv i dendur me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+3 deri P+12), me ISD 2.4 për objektet afariste dhe ISD 2.4 për banim.



## TËRËSIA "B"

### Karakteristikat ambientale

**Tërësia B** e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione afariste, banim i dendur, tregti, biznes dhe administratë, si dhe funksione përcjellëse (sheshet, bulevardet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat) (B1, B10)
- Blloku me funksion banimi - në kuadër të të cilit funksionojnë elementet përcjellëse siç janë: hapësira për lojra të fëmijëve, sipërfaqet gjelbëruese dhe rekreative, tregtia, terrenet e pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshet, rrugët interne të bllokut, parkingjet, garazhat etj. (B2, B3, B4, B5, B6, B7, B8, B9, B11, B12)
- Në të gjitha blloqet duhet të sigurohet parcela për kopështe dhe çerdhe për fëmijë në kuadër të kompleksit të blloqeve.
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit

### Karakteristikat ekologjike

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijojnë:

- Përcaktimi i masave të shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre,
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane.
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane.
- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individi në vizura, diell dhe ajër.
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize.

## **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane B sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës, është i pashmangshëm sepse një pjesë e kësaj tërësie urbane është e mbuluar me ndërtime të egra.

Në këtë territor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja ndërtimi. Të gjitha blloqet në këtë territor janë planifikuar me destinim banimi të dendur kolektiv dhe afarizëm (tregti, biznes, administratë, etj) (B1, B2, B3, B4, B5, B6, B7, B8, B9, B10, B11, B12).

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të vendbanimeve dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane,
- përqindjet e rëndësishme të gjelbërimit janë të dhëna në standardet urbanistike, në zbatimin e përgatitjes së kushteve kualitative dhe kuantitative jetësore si dhe të punës së banorëve si të kësaj tërësie urbane ashtu edhe të qytetit të Prishtinës.

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Varësisht prej destinimit të blloqeve në kuadër të tërësisë urbane objektet e interesit të përgjithshëm mund të dislokohen prej një blloku në një bllok tjetër, nëse implementimi dhe zbatimi i projekteve në blloqe vjen në pyetje, gjegjësisht nuk gjendet gjuha e përbashkët me pronarët e parcelave.

**Etazhiteti** – tërësia B në zonat e ndërtimit kolektiv të objekteve me banim të dendur dhe afarist është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin strategjik të Prishtinës. Meqenëse një pjesë e kësaj zone bënë pjesë në bulevardin e unazës qendrore (rrugës Mitrovicë – Prishtinë – Shkup) dhe Prishtinë – Aeroport është paraparë që etazhiteti të jetë P+4 deri në P+12, ndërsa për pjesët e brendshme ky etazhitet do të jetë prej P+4 deri në P+7. Etazhiteti P+1 do të ketë ISHP-në 0.6, për hapësirat afariste, ndërsa ISHP-ja për pjesën banuese do të jetë 0.4 (ky indeks është rezultat i kërkesave të individëve

për të pasur të drejtën e tyre për shfrytëzim të vizurave, ajrit dhe diellit). Indekset e rritura në këtë zonë janë rezultat i shfrytëzimit të parcelave të ngarkuara me objekte ekzistuese të cilat ndikojnë në ekonomizimin e shfrytëzimit të hapsirës.

### **Dendësia e banimit – për tërësinë “B” është 825 banorë/ha**

Kjo dendësi është rezultat i shfrytëzimit të hapësirave ndërtuese në zonën e cila është e mbuluar me ndërtime të egra të cilat ndikojnë në ekonomizimin e shfrytëzimit të kësaj hapësire.

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale (kjo nënkuptohet se janë të caktuara sipas sistemit koordinativ).

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i shfrytëzimit të parcelës për kategoritë është:

- Banimi kolektiv i dendur me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+4 deri P+12), me ISHP 0.6 për objektet afariste dhe ISHP 0.4 për banim

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv i dendur me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+4 deri P+12), me ISD 2.4 për objektet afariste dhe ISD 2.4 për banim.
- Për objektet me karakter të interesit të përgjithshëm (shkollat, shëndetësia, kultura, sporti dhe rekreacioni etj.) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok

## TËRËSIA "C"

### Karakteristikat ambientale

**Tërësia C** e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione bulevardi (afariste dhe banim), si dhe funksione përcjellëse (sheshet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat) (C6)
- Blloku me funksion banimi - në kuadër të të cilit funksionojnë elementet përcjellëse siç janë: hapësira për lojra të fëmijëve, sipërfaqet gjelbëruese dhe rekreative, tregtia, terrenet e pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshet, rrugët interne të bllokut, parkingjet, garazhat etj. (C1, C2, C4, C5)
- Parcelat për gjelbërim, rekreim dhe parkim (C3)
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit.

### Karakteristikat ekologjike

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijojnë:

- Përcaktimi i masave shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane
- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individit në vizura, diell dhe ajër
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize

## **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane C sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës, është i pashmangshëm sepse një pjesë e kësaj tërësie urbane është e mbuluar me ndërtime të egra.

Në këtë territor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja ndërtimi. Të gjitha blloqet në këtë territor janë planifikuar me destinim banimi kolektiv dhe ekonomi (C1, C2, C4, C5), bulevardi (C6), biznes dhe tregëti.

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të vendbanimeve dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane
- përqindjet e rëndësishme të gjelbërimit janë të dhëna në standardet urbanistike, në zbatimin e përgatitjes së kushteve kualitative dhe kuantitative jetësore si dhe të punës së banorëve si të kësaj tërësie urbane ashtu edhe të qytetit të Prishtinës

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Varësisht prej destinimit të blloqeve në kuadër të tërësisë urbane objektet e interesit të përgjithshëm mund të dislokohen prej një blloku në një bllok tjetër, nëse implementimi dhe zbatimi i projekteve në blloqe vjen në pyetje, gjegjësisht nuk gjendet gjuha e përbashkët me pronarët e parcelave.

**Etazhiteti** – tërësia C në zonat e ndërtimit kolektiv të objekteve me destinim banimi dhe afarizmi është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin strategjik të Prishtinës. Meqenëse një pjesë e kësaj zone bënë pjesë në bulevardin e unazës qendrore (rrugës Mitrovicë – Prishtinë – Shkup) dhe Prishtinë – Aeroport është paraparë që etazhiteti të jetë P+4 deri në P+7, ndërsa për pjesët e brendshme ky etazhitet do të jetë prej P+2 deri në P+5. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP për pjesën banuese dhe afariste do të jetë 0.3-0.4.

**Dendësia e ndërtimit** – për tërësinë “C” është **542 banorë/ha**

Kjo dendësi është rezultat i shfrytëzimit të hapësirave ndërtuese në zonën e cila është e mbuluar me ndërtime të egra të cilat ndikojnë në ekonomizimin e shfrytëzimit të kësaj hapësire.

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale (kjo nënkuptohet se janë të caktuara sipas sistemit koordinativ).

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+3 deri P+10), me ISHP 0.5 për objekte afariste, ndërsa për objekte banimi 0.4

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv i dendur me afarizëm (tregti, administratë, biznes) me etazhitet (P+4 deri P+7), me ISD 2.0
- Për objektet me karakter të interesit të përgjithshëm (shkollat, shëndetësia, kultura, sporti dhe rekreacioni etj.) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok

## TËRËSIA "D"

### Karakteristikat ambientale

Tërësia D e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione bulevardi (afariste dhe banim), si dhe funksione përcjellëse (sheshet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat) (D4)
- Blloku me funksion banimi dhe afarizëm - në kuadër të të cilit funksionojnë elementet përcjellëse siç janë: hapësira për lojra të fëmijëve, sipërfaqet gjelbëruese dhe rekreative, tregtia, terrenet e pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshet, rrugët interne të bllokut, parkingjet, garazhat etj. (D1, D2, D3)
- Në të gjitha blloqet duhet të sigurohet parcela për kopështe dhe çerdhe për fëmijë në kuadër të kompleksit të blloqeve
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit.

### Karakteristikat ekologjike

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijojnë:

- Përcaktimi i masave shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane
- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individit në vizura, diell dhe ajër.
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize

## **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane D sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës, është i pashmangshëm sepse një pjesë e kësaj tërësie urbane është e mbuluar me ndërtime të egra.

Në këtë territor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja ndërtimi. Të gjitha blloqet në këtë territor janë planifikuar me destinim banimi kolektiv (D1, D2, D3), bulevardi (D4).

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të vendbanimeve dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane
- përqindjet e rëndësishme të gjelbërimit janë të dhëna në standardet urbanistike, në zbatimin e përgatitjes së kushteve kualitative dhe kuantitative jetësore si dhe të punës së banorëve si të kësaj tërësie urbane ashtu edhe të qytetit të Prishtinës

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Varësisht prej destinimit të blloqeve në kuadër të tërësisë urbane objektet e interesit të përgjithshëm mund të dislokohen prej një blloku në një bllok tjetër, nëse implementimi dhe zbatimi i projekteve në blloqe vjen në pyetje, gjegjësisht nuk gjendet gjuha e përbashkët me pronarët e parcelave.

**Etazhiteti** – tërësia D në zonat e ndërtimit kolektiv të objekteve me destinim banimi dhe afarizmi është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin strategjik të Prishtinës. Meqenëse një pjesë e kësaj zone bënë pjesë në bulevardin e unazës qendrore (rrugës Mitrovicë – Prishtinë – Shkup) dhe Prishtinë – Aeroport është paraparë që etazhiteti të jetë P+3 deri në P+5, ndërsa për pjesët e brendshme ky etazhitet do të jetë prej P+2 deri në P+4. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP për pjesën banuese dhe afariste do të jetë 0.3 - 0.4.



### **Dendësia e ndërtimit – për tërësinë “D” është 501 banorë/ha**

Kjo dendësi është rezultat i shfrytëzimit të hapësirave ndërtuese në zonën e cila është e mbuluar me ndërtime të egra të cilat ndikojnë në ekonomizimin e shfrytëzimit të kësaj hapësire.

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale (kjo nënkuptohet se janë të caktuara sipas sistemit koordinativ).

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv me etazhitet (P+3 deri P+5), me ISHP 0.3 - 0.4

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi kolektiv me etazhitet (P+3 deri P+5), me ISD 1.2
- Për objektet me karakter të interesit të përgjithshëm (shkollat, shëndetësia, kultura sporti dhe rekreacioni etj.) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok

## TËRËSIA "E"

### Karakteristikat ambientale

Tërësia E e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione bulevardi (afariste dhe administratë), si dhe funksione përcjellëse (sheshet, lulishtet, oazat e gjelbëruara, parkingjet dhe garazhat) (E1-TrAd, E2-TrAd, E14-TrAd)
- Blloku me funksion stacioni i Autobusave si dhe stacioni i trenit urban të cilët funksionojnë si një tërësi me hapësira për pasagjer (terminali), sipërfaqe gjelbëruese dhe rekreative, restorane, terrene të pandërtuara komunale nëntokësore dhe mbitokësore, sheshe, rrugë interne të bllokut, parkingje etj. (E3-SA1, E3-SA2, E3-SA3, E3-OShP)
- Parcela me funksion – ekonomi e vogël dhe të mesme (E4-EV, E5-EV, E6-EV, E7-EV, E8-EV, E9-EV1, E9-EV2, E11-EV1, E11-EV2, E12-EV, E13-EV)
- Parcela me funksione shkollore (E7-ShMB, E7-FB, E9-DB)
- Parcela me funksione policore (E11-Pol)
- Parcela për gjelbërim (E10-GjL, E12-GjL)
- Parcela me funksion trafostacioni (E10-Trafo)
- Parcela me funksione administrimi i ujësjellësit (E13-Uji)
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit

### Karakteristikat ekologjike

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore dhe të punës do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijojnë:

- Përcaktimi i masave shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane

- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individit në vizura, diell dhe ajër
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize

### **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane E sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës, është i pashmangshëm sepse një pjesë e kësaj tërësie urbane është e uzurpuar dhe e ndërtuar me ndërtime të egra. Ky teritor ka funksionuar në kuadër të zonës industriale me një industri të lehtë e cila nuk e ka ndotur ambientin. Kjo zonë edhe në të ardhmen do të funksionoj si zonë ekonomike me destinime të reja.

- Në këtë teritor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja ndërtimi. Të gjitha blloqet në këtë teritor janë planifikuar me destinim ekonomik (E4-EV, E5-EV, E6-EV, E8-EV, E9-EV1, E9-EV2, E11-EV1, E11-EV2, E12-EV, E13-EV), bulevardi (E1-TrAd, E2-TrAd, E14-TrAd), objekte shërbyese (E10-Trafo, E13-Uji), objekte edukative (E7-ShMB, E7-FB, E9-DB), dhe hapsira gjelbërimi përreth rrugës unazore.

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të hapsirave ekonomike dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane
- përqindjet e rëndësishme të gjelbërimit janë të dhëna në standardet urbanistike, në zbatimin e përgatitjes së kushteve kualitative dhe kuantitative jetësore dhe të punës së banorëve, si të kësaj tërësie urbane ashtu edhe të qytetit të Prishtinës.

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

**Etazhiteti** – tërësia E në zonat e ndërtimit kolektiv të objekteve me destinim banimi dhe afarizmi është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin

strategjik të Prishtinës. Meqenëse një pjesë e kësaj zone bënë pjesë në bulevardin në mes të unazës qendrore dhe të brendëshme (rruga Pejë - Prishtinë) është paraparë që etazhiteti të jetë P+4 deri në P+10, ndërsa për pjesët e brendshme ky etazhitet do të jetë prej P+1 deri në P+2. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP afariste-ekonomike do të jetë 0.6.

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - janë të prezantuara me shtojcat grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë dhënë në formën digjitale (kjo nënkuptohet se janë të caktuara sipas sistemit koordinativ).

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Objektet për tregëti dhe administratë (P+4 deri P+10), me ISHP 0.6
- Për objektet me karakter ekonomik dhe të interesit të përgjithshëm (shkollat, fakultetet) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok.

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Objektet për tregëti dhe administratë (P+4 deri P+10), me ISD 2.4
- Për objektet me karakter ekonomik të interesit të përgjithshëm (shkollat, fakultetet) koeficientet janë dhënë në tabelën përkatëse për çdo bllok.

## TËRËSIA "F"

### Karakteristikat ambientale

Tërësia e territorit të Lagjes "Kalabria" është se kjo sipas planit strategjik të Prishtinës ben pjesë në zonat për gjelbrim dhe rekreacion për tërë qytetin e Prishtinës. Karakteristikë tjetër e kësaj zone është se territori i saj është i mbuluar me ndërtime të egra të cilat në këtë plan janë të trajtuara dhe si rezultat i këtij trajtimi do të konzervohen në atë gjendje që janë.

Tërësia F e territorit të lagjes "Kalabria" është me karakteristika të veçanta të konceptit bashkëkohor urban. Kjo tërësi sipas planit rregullativ është e ndarë në këto blloqe:

- Blloku me funksione shkollore, gjelbrimi, banimi individual egzistues (F1)
- Blloku me funksione gjelbrimi, rekreimi, banimi individual egzistues, objekte hoteliere, hapsirë për shkollë fillore (F2)
- Blloku me funksione gjelbrimi, rekreimi, banimi individual egzistues, hapsira për shkolla fillore, hapsira banim luksoz, për objekte shëndetsore, për objekte hoteliere, sportive etj. (F3, F4)
- Plani përmes rregullave të parcelimit, rregullimit dhe rregullave zbatuese, i përcakton principet e ndërtimit të cilat do ta afirmojnë karakterin ambiental si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe të ambientit

### Karakteristikat ekologjike

Duke u bazuar në karakterin e tërësisë urbane, kushtet jetësore do të jenë në nivel të qyteteve bashkëkohore. Me plan përcaktohen situatat e përgjithshme progresive ekologjike sipas masave që vijnë:

- Përcaktimi i masave të shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve europiane
- Planifikimi i kushteve optimale për evakuimin e mbeturinave dhe për kalimin e automjeteve për intervenime sipas standardeve europiane
- Vendosja e rendit urban përmes rregullave të shfrytëzimit të tokës, rregullave të ndërtimit dhe rregullave të parcelimit, si parakusht bazë për përcaktimin e të drejtave të çdo individit në vizura, diell dhe ajër.
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize

## **Karakteri i intervenimit**

Intervenimi në tërësinë urbane F sipas strukturës ekzistuese urbane të zonës është i pashmangshëm sepse një pjesë e kësaj tërësie urbane është e mbuluar me ndërtime të egra.

Në këtë territor është vendosur kontinuiteti me rrugët ekzistuese sipas planit strategjik zhvillimor urban, gjegjësisht janë formuar blloqe të reja. Të gjitha blloqet në këtë territor janë planifikuar me destinim gjelbrimi, rekreacioni, banimi luksoz, hotelier, sportiv, si dhe konzervimi i objekteve ekzistuese. (F1, F2, F3 F4).

**Intensifikimi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP)** – është shprehur përmes indeksave të shfrytëzimit të parcelës (ISHP), si dhe indeksave të sipërfaqeve të dysHEMEVE (ISD).

Në këtë tërësi urbane zhvillimi i infrastrukturës do të bëhet sipas kërkesave bashkëkohore, që konsiston në:

- zhvillimin e infrastrukturës të vendbanimeve dhe pjesëve tjera të kësaj tërësie, që rezulton në perspektivën dhe standardin më të lartë higjienik sipas normave europiane
- përqindjet e rëndësishme të gjelbërimit janë të dhëna në standardet urbanistike, në zbatimin e përgatitjes së kushteve kualitative dhe kuantitative jetësore si dhe të punës së banorëve si të kësaj tërësie urbane ashtu edhe të qytetit të Prishtinës

**Zonat e ndërtimit** – janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelare. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, standardet dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelare për çdo bllok.

Varësisht prej destinimit të blloqeve në kuadër të tërësisë urbane objektet e interesit të përgjithshëm mund të dislokohen prej një blloku në një bllok tjetër, nëse implementimi dhe zbatimi i projekteve në blloqe vjen në pyetje, gjegjësisht nuk gjendet gjuha e përbashkët me pronarët e parcelave.

**Etazhiteti** – tërësia F në blloqe të kësaj zone është e llogaritur sipas indeksave të dhënë në planin strategjik të Prishtinës. Etazhiteti do të jetë prej P+0 deri në P+1. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP për pjesën banuese do të jetë 0.1 - 0.15.

**Dendësia e ndërtimit** – për tërësinë “F” është **26 banorë/ha**

Kjo dendësi është rezultat i shfrytëzimit të hapësirave gjelbëruese me një indeks shfrytëzues minimal i cili ndikon në përmirsimin e ambientit egzistues dhe na jep një kualitet të lartë ambiental.

**Vijat ndërtimore dhe rregulluese** - do të caktohen sipas rregullave urbanistike gjate hartimit të projektit urbanistiko arkitektonik.

**Indeksi i shfrytëzimit të parcelës “ISHP”** – jepet për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi luksoz (P+0 deri P+1), me ISHP 0.1 - 0.15

**Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë “ISD”** – është dhënë për çdo bllok në mënyrë të veçantë në tabelën e bilancit të sipërfaqeve. Përgjithësisht indeksi i sipërfaqes së dyshemesë për kategoritë është:

- Banimi luksoz me etazhitet (P+0 deri P+1), me ISD 0.3

## **4. RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PARCELAVE SIPAS TËRËSIVE URBANE**

### **PARIMET E PËRGJITHSHME TË RREGULLIMIT**

#### **TREGUESIT URBANISTIK**

Rregullimi i parcelave përcaktohet me këtë plan dhe bazohet në sistemin e elementeve të rregullimit dhe atë:

- sistemi urbanistik i treguesve (indeksi i shfrytëzimit të parcelës - ISHP, dhe indeksi i sipërfaqes së dyshemesë - ISD)
- rregullat urbanistike të vijave rregullative (parcelës, zonës), vijave ndërtimore, vijave të boshtit të rrugës si dhe vijës kufitare të lagjes “Kalabria”

Sistemi i raporteve urbanistike, rregullon parimet e rregullimit të hapësirës dhe ndërtimit (vendosja e objekteve, distanca e objekteve, lartësia e objekteve, vendosja e rrethojave, parkimi, garazhimet dhe të tjera).

**Treguesit Urbanistik** shërbejnë për kontrollin e hapësirës banuese dhe kualitetit të raporteve në mes fqinjëve. Treguesit themelor urbanistik janë: koeficienti i ndërtimit, shkalla e shfrytëzimit, vija rregullative, vija ndërtimore, rregullimi i lartësisë dhe nivelimi.

#### **Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP**

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP, është raporti në mes të sipërfaqes bruto nën objekt dhe sipërfaqes së parcelës ndërtimore. Në këtë plan përcaktohet dhe zbatohet në këta kufij:

- për parcelat e tipit të banimit kolektiv (tërësia D), është 0.3 - 0.4
- për parcelat me destinim të përzier banim kolektiv dhe ekonomi (tërësia C) është 0.4 - 0.6
- për parcelat me destinim të përzier banim i dendur, biznes, afarizëm dhe tregti (tërësia A, B), është 0.3 - 0.4 për pjesën banuese mbi objektet afariste ndërsa 0.6 për pjesën afariste (përdhesë dhe kat)
- për objektet ekonomike është 0.6



### **Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë ISD**

Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë ISD (raporti në mes sipërfaqes bruto të të gjitha etazheve të sipërfaqes shfrytëzuese dhe hapësirës së parcelës) përcaktohet me këtë plan, dhe zbatohet në këta kufij:

- në zonën e ndërtimit kolektiv banesor (tërësia D) max. 1.2
- në zonën e përzier - ndërtimit kolektiv banesor dhe ekonomik (tërësia C) max. 2.0
- në zonën e ndërtimit të përzier – banim i dendur, biznes, afarizëm, tregti, (tërësia A, B) max 2.4

### **Zbatimi i indeksit të sipërfaqes së dyshemesë ISD**

Duhet të respektohet në tërësi sipas Planit Strategjik të Prishtinës, por duhet të këtë përjashtime për zonat e bulevardit përreth unazës qendrore (rruga Mitrovicë – Shkup, Fushë Kosovë – Prishtinë dhe rrugës së projektuar për aeroport). Në këto zona do të përdoret ISD-ja e cila do të jetë max 3.2.

### **Zbatimi i koeficientit të ndërtimit në rastet e veçanta**

Sipërfaqet e rregulluara të parcelave me objektet e karakterit të përbashkët (parqet, objektet shëndetësore, shkollat etj.) nuk mund të ndikojnë në koeficientin e shfrytëzimit të parcelave fqinje të cilat kanë destinim tjetër. Koeficienti i ndërtimit tregohet, sipas rregullit, për pjesën e hapësirës (tërësinë, zonën) e cila ka destinim karakteristik vetëm për banimin, zona qendrore, zona ekonomike dhe ngjashëm.

### **Vija rregullative**

Vija rregullative tregon vijën e ndarjes së parcelës për interes të përbashkët nga parcela në vendbanimin e paraparë për interes të veçantë. Vija rregullative siguron nga njëra anë funksionimin normal të aktiviteteve në hapësirat me interes të përbashkët (komunikacionit) ndërsa nga ana tjetër mbron interesin e veçantë.

### **Përcaktimi i vijës rregullative**

- Vijat rregulluese dhe boshti i komunikacionit përbëjnë bazat e elementeve për përcaktimin e rrjetit të komunikacionit

- Largësia në mes të vijave rregulluese (gjerësia e shiritit rregullues) janë të përcaktuara varësisht nga funksioni dhe rangu i rrugës
- Definohet si horizontale, vertikale, mbitokësore dhe nëntokësore
- Gjerësia e shiritit rregullues (largësia në mes vijave rregullative) në zonat e planifikuara i ka këto vlera:
  - rregullacioni më i vogël i lejuar përgjithësisht, është 8.00 m
  - për rrugët banesore më së paku 8.00 m
  - rrugët përmbledhëse më së paku 10.00 m
  - për rrugët interne (rrugë servise me komunikacion të këmbësoreve) më së paku 6.00 m,
  - rrugët primare 17.0 – 23.00 m
  - rrugët sekondare 12.00 – 14.00 m

#### Vija rregullative dhe rrjeti i komunikacionit

Vijat rregulluese dhe boshti i komunikacionit përbëjnë bazat e elementeve për përcaktimin e rrjetit të komunikacionit.

#### Vija rregulluese e parcelës në kënd

Me planin rregullativ përcaktohet kryqëzimi për rastet karakteristike. Me këtë plan vijat rregulluese të kulmeve bashkohen detyrimisht me vijën e cila i lidh pikat kulmore të vijave rregulluese.

#### Vijat rregullative dhe infrastruktura

Vija rregullative siguron korridorin për vendosjen rrjetës (primare dhe sekondare) të infrastrukturës (ujësjellësit, kanalizimit, PTT, rrjetit të gazit, ngrohjes, largpërçuesve, naftësjellësit, gazsjellësit magjstral, rrjeta ngrohëse, e të ngjashme), në qytet dhe vendbanime.

Plani rregullativ definon kuotat e domosdoshme të niveletave për sigurimin e kyçjeve të objekteve në fazën e projektimit urbanistiko-arkitektonik (projekt urbanistik).

#### Vija ndërtimore

Vija ndërtimore përcaktohet me këtë plan rregullativ dhe është meritore për projektin urbanistik dhe lejen urbanistike. Në dokumentacionin e cekur me këtë plan, vija ndërtimore përherë përcaktohet në raport me vijën rregullative.

Vija ndërtimore mund të përputhet me vijën rregullative ose mund të jetë në largësi ligjore (5 – 8 m) nga vija rregullative në parcelën ndërtimore.

Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur me fasadën e përparme në vijën ndërtimore respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore.

Vija ndërtimore sipas destinimit, në këtë plan është e definuar me sistemin koordinativ dhe mund të jetë:

- Objektet kolektive banesore, përcaktohen në vijën ndërtimore e cila largësi mund të jetë, prej 0 - 7.00 m, respektivisht ndaj vijës së përcaktuar ndërtimore të objekteve fqinje të ndërtuara
- Objektet kolektive banesore në këndet ndërtimore, vendosen në vijën ndërtimore largësia e të cilave, mund të jetë nga 0-7.00 m, respektivisht ndaj vijës së përcaktuar ndërtimore të objekteve të ndërtuara.
- Objektet afariste dhe objektet tjera vendosen në vijën ndërtimore të përcaktuara me fletat grafike të Planit Rregullativ.

#### Vendosja e objektit në vijën ndërtimore

Secili objekt duhet të jetë i vendosur me fasadën e përparme në vijën ndërtimore apo si është e përcaktuar me planin rregullativ. Për disa arsye të caktuara estetike, funksionale apo të natyrës ekologjike me këtë plan rregullativ parashihet shmangia nga vija e ndërtimit, me kusht që të përcaktohet mënyra e shfrytëzimit të parahapsirës dhe atë përmes projektit Urbanistik respektivisht lejes Urbanistike.

#### Vija nëntokësore ndërtimore

Objektet nëntokësore (pjesët e objekteve, strehimoret, garazhat e të ngjashme) sipas nevojës mund të përcaktohen përmes lejes urbanistike dhe në shiritin në mes vijës rregullative dhe asaj ndërtimore, si dhe në oborrin e brendshëm jashtë gabaritit të objektit, nëse kjo nuk paraqet pengesë në rrjetin ekzistues apo rrjetin e planifikuar të infrastrukturës komunale. Për këto raste me lejen urbanistike përcaktohet vija nëntokësore ndërtimore.

Objektet nëntokësore ndërtimore të cilat ndërtohen në zonën e interesit të përbashkët, në mes vijave rregullative, siç janë kalimet e veçanta të këmbësoreve, kalimet nëntokësore dhe garazheve, infrastruktura e stabilimenteve etj. përcaktohen me vijën nëntokësore ndërtimore në harmoni me planin rregullativ.

Vija ndërtimore nëntokësore mund të përcaktohet edhe me projektin Urbanistik për ato pjesë të zonës të cilat në momentin e aprovimit të këtij plani nuk kanë pasur elemente dhe kushte për përcaktimin e kërkesës së tillë.

### Vija ndërtimore mbitokësore (mbikalime)

Objektet ndërtimore mbitokësore (mbikalime) të cilat ndërtohen në zonën e interesit të përbashkët, në mes vijave rregullative, siç janë kalimet mbitokësore të këmbësoreve, pasarelat mbitokësore si dhe lidhjet e dy objekteve përmbi rrugën publike dhe të ngjashme, përcaktohen me vijën ndërtimore mbitokësore në planin urbanistik. Vija mbitokësore ndërtimore në këtë rast përcaktohet edhe me rregullimin e lartësisë.

### Distanca mes objekteve

Distanca mes objekteve të cilat ndërtohen në rend të ndërprerë është së paku  $\frac{1}{2}$  e lartësisë së objektit më të lartë, duke mos i marrë parasysh shumëkatëshet e veçuara. Largësia mund të zvogëlohet në gjysmë nëse objekti në fasadat anësore nuk përmban hapësira për banim (kjo nënkupton atele dhe hapësira afariste). Kjo largësi nuk mund të jetë më e vogël se 4.00 m nëse njëri prej mureve të objektit përbën hapësira për ndriçim ditor.

Për objektet e banimit shumëkatësh të veçuara, kushtet plotësuese për distance në mes veti janë: që objekti nuk duhet të pengoj diellin objektit tjetër më tepër se  $\frac{1}{2}$  e kohës së ndriçimit direkt me diell.

### Lartësia e objektit

